

Informacion mbi TRYEZËN E DISKUTIMIT “STATISTIKAT”

Në kuadrin e veprimtarive për integrimin evropian, INSTAT është institucioni përgjegjës për përputhshmërinë e akteve komunitare të parashikuara në Kapitullin 18 “Statistikat”, në bashkëpunim me agjensitë statistikore Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Aktet komunitare (acquis communautaire) në fushën e statistikave përbëhen nga legjislacioni i cili është direkt i zbatueshëm në Shtetet Anëtare të KE, siç janë Rregulloret e Parlamentit Evropian, Rregulloret e Këshillit Evropian, Vendimet e tyre dhe Rregulloret e Komisionit Evropian. Aktet komunitare mbi statistikën përmbajnë gjithashtu një gamë të gjerë të udhëzuesve metodologjikë në fusha të ndryshme statistikore si politikën ekonomike dhe monetare, statistikën demografike dhe sociale, statistikën sektoriale si Bujqësia, Energjia, Transporti, Turizmi, etj, si dhe inovacioni apo teknologjia e informacionit. Standardet ndërkombëtare si parimet themelore të statistikave dhe kodi i praktikave të statistikave evropiane ofrojnë parimet bazë mbi të cilat duhet të mbështetet prodhimi dhe përhapja e statistikave zyrtare. Mbështetur në VKM nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” si dhe në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit të RSH, nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”, ftohet të marrin pjesë lirisht përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, të mediave dhe grupeve të interesit, duke shprehur interesin e tyre për tu bërë anëtarë të tryezës së kapitullit të 18-të “Statistikat”, në kuadër të Grupeve Institucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE).

Për sa më sipër, INSTAT njoftoi në faqen elektronike të institucionit, afishoi njoftimin në hyrje të INSTAT, gjithashtu dërgoi me email njoftimin e plotë tek kontaktet që mund të kishin interes si dhe njoftoi anëtarët e tjerë të GNPIE, për kapitullin Statistikat për ta ndarë njoftimin me personat e interesuar.

Në takimin e radhës të GNPIE u vendos krijimi i një komisioni me përfaqësues nga INSTAT, Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Komisioni do të kishte për detyrë shqyrtim e të gjithë kandidatëve të cilët do të ishin një vlerë e shtuar për tryezat e diskutimit si dhe të analizonte dhe vlerësonte të gjitha cv-të që kishin dërguar kandidatët që kanë shprehur interes për të qënë pjese e tryezës së diskutimit.

Në mbledhjen e komisionit në datë 17/10/2019 u përzgjedhën me konsensusin e të gjithë anëtarëve kandidaturat si më poshte vijon:

- Ariola Kallciu , ofron ekspertizën e saj nga “World Vision Albania”.
- Merita Toska , ofron ekspertizën e saj nga Co-PLAN “Instituti për Zhvillimin e Habitatit”.
- Altin Hazizaj, ofron ekspertizën e tij nga CRCA “Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri”.
- Arben Shkodra, ofron ekspertizën e tij nga “Bashkimi i Prodhuesve Shqipëtarë”.

- Mihallaq Qirko, ofron ekspertizën e tij nga “Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri”.
- Mirela Arqimandriti, ofron ekspertizën e saj në çështjet e barazisë gjinore dhe kërkimet në fushën socio-ekonomike.
- Aurora Binjaku, ofron ekspertizën e saj nga “Universiteti Europian i Tiranës”.
- Irma Guga, ofron ekspertizën e saj nga “Universiteti Europian i Tiranës”.

Kandidatët e përzgjedhur janë njoftuar nga INSTAT dhe iu është bërë me dije se do të njoftohen shume shpejt për të marrë pjesë në takimet e radhës.